



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Kukës me, ____ . ____ .2021

VENDIM

Nr. 35 Datë 25.3.2021

PËR

PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË BASHKINË KUKËS PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE EDUKUESE ZGJEDHORE NGA PARTITE POLITIKE DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 64, ligjit Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative ne RSH, ligjit Nr.10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë”(i ndryshuar) neni 79, udhezimit te KQZ-se Nr.6, date 23.03.2021 “Për perdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat per afishimin e tyre gjate fushates zgjedhore”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1.Të percaktoj vendet e afishimit te materialeve propagandistike ne territorin e Bashkise Kukes, sipas përmbajtjes se mëposhtme:

- sheshet, pergjate rrugeve jashte qytetese, si dhe vitrinat e njesive ose objekteve private qe nuk kane destinacion banimi.

2.Të percaktoj vendet e afishimit te materialeve edukuese zgjedhore ne territorin e Bashkise Kukes, sipas përmbajtjes se mëposhtme:

- Sheshi perballe bashkise prane Muzeut Etnografik.
- Pranë zyrave dhe ambienteve të çdo njësie administrative të Bashkisë Kukës

3.Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike ne fasadat e godinave te banimit, institucioneve publike apo ambientet rrethuese, brenda zonave rekreative, parqeve, pemet e qytetit, shtyllat e ndriçimit dhe mjetet e transportit publik.

4.Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.

5.Materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor).

6.Me mbarimin e fushates zgjedhore subjektet zgjedhore te marrin masa per heqjen e te gjithë materialeve propagandistike.

7.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Policia Bashkiake si dhe Drejtoria Juridike, PP dhe IT.

8.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Safet GJICI

The stamp is circular and contains the text "REPUBLIKË E SHqipëRISE" at the top, "BASHKIA KUKËS" at the bottom, and a central emblem. A blue ink signature is written over the stamp.